



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 2823/Prot.
3

Tiranë, më 24/01/2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin *Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.*

REKOMANDIM ³
Nr. 01 datë 24/01 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.**

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.13, datë 31.07.2012 pranë kontrolluesit Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë është realizuar kontrolli administrativ nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolli pranë këtij kontrolluesi u krye sipas objektit të përcaktuar në Urdhërin e sipërcituar të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe konkretisht:

Objekti i kontrollit ishte tematik:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të dixhitalizuar të procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar në lidhje me:**
- ✚ Verifikimin e kategorive të subjekteve që ju përpunohen të dhënat, përkundrejt qëllimit nëpërmjet këtij sistemi;
- ✚ Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave me anë të sistemit;

- ✦ Informimin e subjekteve të të dhënave;
- ✦ Cilësinë e të dhënave personale;
- ✦ Siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave që përpunohen.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi ZRPP Tiranë ka në proces zhvillimi dhe pjesërisht aktiv Sistemin e Regjistrimit Elektronik të Pasurive të Paluajtshme(ALBSReP) i cili shërben për menaxhimin e proceseve të punës të këtij institucioni. Ky sistem është projektuar, zhvilluar dhe funksionon në bazë të Ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Sistemi i Regjistrimit Elektronik të Pasurive të Paluajtshme(ALBSReP) është një shërbim i llojit one-stop-shop dhe implemtimi i këtij sistemi ka për qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, plotësimin e kërkesave dhe nevojave për subjektet që kanë akses në sistem, zhvillimin dhe sigurinë në qarkullimin civil të pasurive të paluajtshme, rritjen e sigurisë së të dhënave për pasuritë e paluajtshme duke zhvilluar dhe implementuar proceset dixhitale.

Aktualisht në sistem kanë akses vetëm noterët(si palë e tretë e interesuar) ndërsa statuset e tjera janë akoma në proces zhvillimi nga kompania e kontraktuar. Është duke u punuar për një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit.

Noterët e përfitojnë aksesin në sistem nëpërmjet internetit. Punonjësit e teknologjisë dhe informacionit i pajisin me “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalim” përkatës noterët të cilët kanë aplikuar dhe ju është miratuar aksesin në këtë sistem. Aktualisht vetëm noterët të cilët janë të regjistruar në Tiranë kanë mundësi të aplikojnë pranë ZRPP_së për marrje informacioni.

Sistemi është qëndror, i centralizuar. Aktualisht sistemi ndodhet në fazën përfundimtare për sa i përket proceseve të punës të cilat realizohen nga punonjësit e kontrolluesit. Ka përfunduar dhe është në funksionim ndërfaqja e noterëve. Ka përfunduar dhe është në funksionim ndërfaqja për ndjekjen e fazave të aplikimit të qytetarëve. Kjo ndërfaqje ka qëllim që të informojë publikun lidhur me statusin e aplikimit të tyre.

Sistemi është ndërtuar nga një kompani private. I gjithë informacioni i përdorur për bazën e të dhënave është marrë nga regjistrimet e ZRPP-së.

Një nga mangësitë kryesore të kontrolluesit për sa i përket marrjes së masave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është mungesa e një Rregulloreje të Posacme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas parashikimeve të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Përveç subjekteve të të dhënave, sistemi është projektuar i tillë që të bej të mundur edhe aksesin e palëve të treta të interesuara në procesin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme si ILDKP, Noterët, Avokatët etj. Ndërkohë që mundësia për të aksesuar në këtë sistem e palëve të treta është e parashikuar nga kuadri ligjor përkatës, konstatohet se:

Kontrolluesi nuk ka parashikuar rregulla sipas parashikimeve të nenit 5 pika 1/c ku parashikohet: *Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:*

“ në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”.

Sipas parashikimeve të nenit të sipërcituar i cili është edhe një nga parimet bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar përsa i përket përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesit;

palët e treta duhet të kenë akses në të dhënat personale të subjekteve të të dhënave vetëm për atë kategori të dhënash të cilat janë të domosdoshme për qëllimin e veprimtarisë së tyre dhe në asnjë rast të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Për të përcaktuar nga kontrolluesi se cilat janë kategoritë e të dhënave personale ku palët e treta kanë akses, përveç kuadrit ligjor të rregullimit të veprimtarisë së saj Ligji “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, nga kontrolluesi duhet të merret parasysh edhe kuadri ligjor i veprimtarisë së palëve të treta në proces, si Ligji “Mbi avokatinë”, Ligji “Për noterët”, Ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” etj.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27/2/”c” dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartojë Rregulloren e Posacme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose të përfshijë në Rregulloren në proces hartimi Seksionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në rregulloren ku do të reflekohen dispozitat mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përcaktohen në mënyrë të qartë se cilat janë palët e treta që kanë akses dhe kanë të drejtën për t’u informuar në lidhje me këto të dhëna.
3. Në zbatim të nenit 5 pika 1 germa ‘c’ të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të përcaktohet në mënyrë të qartë se cila është kategoria(sasia) e të dhënave tek të cilat duhet të ketë akses cdo palë e tretë në sistem, duke përfshirë këtu subjektet e të dhënave personale, Institucione të tjera si ILDKP, avokatët, noterët etj duke reflektuar edhe parashikimet e ligjeve specifike me të cilat këto institucione veprojnë sipas pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi.
4. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 45(dyzet e pesë) ditësh.
5. Për plotësimin e këtij detyrimi te njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të

qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

